



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 25/1 Prot.

Tiranë, më 7/ 1 / 2019

V E N D I M

Nr. 2, Datë 7 / 1 / 2019

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 191, datë 17.12.2018, të bërë nga F.A kundër Drejtores së shkollës 9-vjeçare “Ismail Klosi” dhe Përgjegjëses të Zyrës Arsimore Mallakastër në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak “bindjes politike” në formën e shoqërimit¹. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se nga ana e Përgjegjëses së Zyrës Arsimore Mallakastër, gjatë inspektimit të kryer në datë 24.05.2018, janë bërë deklaratat të ndryshme dhe kontradiktore si më poshtë: “*Mësuesit të cilëve iu është ndryshuar kontrata pas raportit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë janë: F.A mësuese ndihmëse shkolla “I.Klosi”, ndryshuar kontrata nga “me afat të pacaktuar” në 3-mujore sepse nuk ka marrë pjesë në asnjë nga portalet “Mësues për Shqipërinë”.*

Ndërsa, Drejtoresha e shkollës “Ismail Klosi”, gjatë inspektimit të datës 24.05.2018 ka informuar se: “*Prishja e kontratës për F.A u bë pas raportit të MASR si për të gjithë mësuesit që ishin pjesë e raportit dhe për mësuesit e tjerë që nuk ishin përmendur në raport”.*

Ankuesja shprehet se ka kontradikta në deklaratat e bëra nga Përgjegjësjja e Zyrës Arsimore Mallakastër dhe Drejtoresha e Shkollës “I.Klosi”, pasi drejtoresha e shkollës nuk ka folur për kontratë me afat të përcaktuar 3-mujore, siç është shprehur Përgjegjësjja e ZA Mallakastër,

¹ Referuar Çertifikatës Familjare nr. 012571471, datë 20.04.2018, F.A është bashkëshortja e A.A, aktivist dhe anëtar i subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim” referuar kartës së anëtarësisë nr.33493, datë 14.10.2016.

ndërkohë që drejtoresha e shkollës në emisionin investigativ “STOP” ka deklaruar se F.A ka qenë me kontratë 3-mujore.

Drejtoresha e shkollës “I.Klosi”, gjatë inspektimit të datës 24.05.2018 ka informuar se: *“Në shkollën “I.Klosi” punojnë 4 mësuese ndihmëse: E.A, H.M, A.B dhe F.A. Mësueset E.A dhe H.M janë emëruar si mësuese ndihmëse në datë 30.09.2015 me lëvizje të detyruar për arsye të mbylljes së vendit të punës në shkollat ku ato punonin”*.

Në lidhje sa më sipër, ankuesja informon se deklarata e bërë nga Drejtoresha e shkollës “I.Klosi” është një mashtrim pasi mësuesja E.A nuk ka punuar kurrë si mësuese, por ka punuar edukatore kopshti pa mbaruar shkollën, fakt që e tregon licenca e mësuesit dhe data e marrjes së licencës dhe rastin e mësueses E.A ankuesja e pretendon si krahasues dhe si rast të njëjtë me të.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, rihetimin e çështjes pasi kanë dalë në dritë mashtrime dhe fshehje të fakteve. Bashkëngjitur ankesës, F.A ka dërguar shkresat: nr.41/1, datë 04.04.2018, nr.49, datë 18.04.2018, nr.50, datë 18.04.2018, nr. 50/1, datë 20.04.2018, nr. 51, datë 23.04.2018, nr.51/1, datë 23.04.2018, nr.52, datë 24.04.2018, nr.60, datë 03.05.2018, nr.209, datë 29.03.2018, nr.213/1, datë 03.04.2018, nr. 29, datë 30.10.2018, nr. 101/1, datë 14.09.2016, nr. 655/1, datë 05.10.2016, fotokopje e një faqe të librezës së punës së ankueses dhe foto të emisionit investigativ “STOP”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Pretendimi i ankueses se shkak për diskriminimin e saj është bindja politike dhe lidhja familjare me A.A, aktivist dhe anëtar i subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim” njësia Ballsh, që është bashkëshorti i F.A, përbën një shkak që gëzon mbrojtje sipas nenit 1 të ligjit.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Në lidhje me pretendimin e ankueses për kontradiktat në deklaratat e drejtuesve të institucionit të ZA Mallakastër dhe shkollës “I.Klosi” në lidhje me zgjidhjen e kontratës së punës, Komisioneri vlerëson se ankuesja mund ti drejtohet gjykatës për shqyrtimin e ligjshmërisë së procedurës së ndjekur për prishjen e kontratës së punës mes punëdhënësit dhe punëmarrësit, pasi pretendimi i ngritur nga ankuesja për deklaratat kontradiktore të drejtuesve në lidhje me zgjidhjen e kontratës së punës nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në lidhje me pretendimin për trajtim të pabarabartë me mësuesen E.A, Komisioneri ju bën me dije se:

- Në lidhje me pretendimin e ankueses se është në situatë të njëjtë apo të ngjashme me mësuesen E.A, Komisioneri vlerëson se subjektet nuk janë në situatë të njëjtë apo të ngjashme pasi, mësuesja E.A është punësuar pranë shkollës “I.Klosi” me Vendimin nr.11, datë 30.09.2015, bazuar në Udhëzimin nr.35, datë 30.09.2014 “*Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar*”, ndërsa ankuesja F.A në datë 14.09.2016 ka lidhur kontratën individuale të punës, pa afat të caktuar pranë shkollës “I.Klosi”, bazuar në Udhëzimin nr.38, datë 06.10.2015 “*Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar*”, pra janë punësuar në periudha të ndryshme dhe me procedura emërimi të ndryshme, për më tepër që procedura e punësimit të F.A është konstatuar si shkelje nga grupi i punës i ngritur nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe bazuar në këtë raport janë ndërmarrë dhe hapat për ndryshimin e marrëdhënieve të punës mes F.A dhe shkollës “I.Klosi”.

Bazuar në ankesën nr. 191, datë 17.12.2018 si dhe dokumentacionit dërguar në mbështetje të pretendimeve të saj, evidentohet se ankuesja ka depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga

Diskriminimi të njëjtat prova, që ka patur në dispozicion Komisioneri kur është shprehur me Vendimin nr.151, datë 12.07.2018.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/c të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se: *“Ankesa nuk pranohet nëse e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3, neni 7/1, nenin 32, pika 1/a), si dhe nenin 33, pika 4/c të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së F.A, për shkak se është dhënë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA